



Vlerësimi i Përfituesve të Programit të Punes së Komunitetit të Bankes Botërore -I, (CWP-I)

Konteksti i projektit

Projekti asistoi hartimin dhe zbatimin e një metodologjie për të vlerësuar perfitimet e zbatimit të projektit për infrastrukturën të financuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit nën grantin e Bankës Botërore. Vlerësimi adreson të gjithë komponentët e Programit të Punëve të Komunitetit, aspektet e përfitimit dhe matjen e nivelit të kënaqshmërisë së arritur nga programi deri tani, siç janë ndikimi social dhe ekonomik, zhvillimi i kapaciteteve lokale, niveli i kënaqësisë së perfituar.

Metodologjia

Instrumentet e vlerësimit: Anketimi në terren dhe diskutimet me Grupet e Fokusuara. Subjekt i këtij studimi ishte një listë prej 42 nënprojektesh, që do të thotë 19.17 % e 219 nënprojekteve të zbatuara deri në atë kohë nën programin e punës me komunitetin. Rezultatet dhe rekomandimet e Impaktit dhe vlerësimit të përfituesve u morën në konsideratë gjatë hartimit të Punes në Komunitet Kjo kontrate përfshiu dhe organizimin e një seminari kombëtar në Tiranë në Korrik 2002 për të bërë të njohura rezultatet e vlerësimit të



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

përfituesve. Vlerësimi brenda kornizave të Studimit të Përfituesve dhe Studimit të Impaktit (BAIS) të Programit të Punës me Komunitetin të financuar nga Banka Botërore, Qeveria Shqiptare dhe donatorë të tjerë është i rëndësishëm për vazhdimësinë e aktiviteteve të FSHZH dhe shpërndarjes së fondeve të tjera të mundshme nga Banka Botërore e donatore të tjerë.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)/Banka Botërore

KOHËZGJATIA:

Janar 2002 – Shtator 2002

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.